



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 qershor 2023
Nr. ref.: RK 2219/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI50/23

Parashtrues

Brikenda Kryeziu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev.nr.387/2022 të 22 nëntor 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Brikenda Kryeziu, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga Blerim Xharavina, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev.nr.387/2022] e 22 nëntor 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.794/19] të 19 majit 2022 të Gjykatës se Apelit të Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.184/2017] të 31 dhjetorit 2018 të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregull) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 shkurt 2023, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 mars 2023, përfaqësuesi i parashtrueses se kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
7. Më 7 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR.KI50/23] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 14 mars 2023, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 7 qershor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës është e punësuar në Kompaninë e Postës dhe Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi).

11. Parashtruesja e kërkesës përmes shumë kontratave të nënshkuara dhe të azhurnuara kishte krijuara marrëdhënie pune me punëdhënësin në pozitën Koordinator Regjional në Gjakovë, me gradën 12.
12. Parashtruesja e kërkesës përmes kontratës [nr.01-1619/2012] të 2 prillit 2012 kishte azhurnuar marrëdhënien e saj të punës me punëdhënësin, nga 1 shkurti 2012 deri në kohe të pacaktuar në pozitën Koordinator Regjional për Shpërndarje dhe Dorëzim me gradën 11.
13. Parashtruesja e kërkesës përmes kontratës [nr.01-756/2013] të 18 marsit 2013 ishte në marrëdhënie punë të punëdhënësi nga 1 marsi 2013 deri në kohë të pacaktuar në pozitën Koordinator Regjional për Shpërndarje dhe Dorëzim me gradën 10.
14. Më 29 korrik 2016, Bordi i Drejtorëve në bazë të Ligjit, nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit, nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përmes vendimit [nr.01-2212/16], përveç tjerash, miratoj rregulloren për kategorizimin e gradave për të punësuarit.
15. Parashtruesja e kërkesës përmes kontratës [nr.01-637/2017] të 7 marsit 2017 ishte në marrëdhënie pune të punëdhënësi në pozitën Zyrtare e Shitjes dhe Marketingu për periudhën kohore nga 1 marsi 2017 deri në kohë të pacaktuar. Përmes nenit 5 të kësaj kontrate, parashtrueses se kërkesës i ishte caktuar paga bazë në lartësi të gradës 7. Në nenin 14 të kontratës se punës se lidhur mes parashtrueses se kërkesës dhe punëdhënësit është përcaktuar se të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi nëse: 1) ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike, ose organizative; 2) i punësuarit që nuk është me i aftë të kryej detyrat e punës; 3) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit; 4) për shkak të mos përmbushjes së pakënaqshëm të detyrave të punës dhe 5) për rastet e tjera, të cilat janë përcaktuar me Ligjin e Punës.
16. Më 14 mars 2017, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë drejtuar Komisionit të Ankesave kundër vendimit [nr.01-2212/16] të 29 korrikut 2016 duke theksuar se *“përmes ankesës së deponuar shfrytëzoj të drejtën ligjore të ankesës mbi vendimin për degradim nga grada 10 në gradën 7. Konsideroj që ky vendim është shkelje ligjore bazuar në ligjin e punës për të cilën ju adresoj rastin për shqyrtim brenda afate kohore të përcaktuara me ligj.”*
17. Më 5 prill 2017, parashtruesja e kërkesës përmes një shkresë iu drejtua Kryeshefit Ekzekutiv të Postës së Kosovës duke kërkuar anulim të vendimit [nr.01-2212/16] të 29 korrikut 2016 dhe kontratës së punës të 7 marsit 2017.
18. Më 27 prill 2017, punëdhënësi përmes vendimit [nr.01-1263/17] (i) refuzoj si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës; (ii) rekomandohet Drejtoria Operative në bashkëpunim me Drejtorinë e RNJAP dhe financave që të mundësojnë transferimin e punëtoreve konform nevojave, përgatitjes profesionale dhe aftësive të saja personale, në vendin e punës me lokacion në Prishtinë.
19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore me kërkesë që të anulohet vendimi për ristrukturim [nr.01-2212/16] i 29 korrikut 2016 i nxjerrë nga Bordi i Drejtorëve si dhe rregulloren për kategorizimin e gradave për të punësuarit, me kusht që me pas të anulohet edhe kontrata e punës [nr.01-637/17] të 7 marsit 2017, ashtu që të detyrohet e paditura që të kthej paditësen në pozitën e njëjtë si ka qenë *“koordinatore regjionale për shpërndarje dhe dorëzim”* me gradën 10 dhe me page të njëjta nga 1 qershori 2018 e tutje, si dhe të detyrohet

punëdhënësi që të ia paguaj parashtrueses së kërkesës ndryshimin e kompensimit të pagës në vlerë prej 3, 495.88 euro për periudhën nga 1 marsi 2017 deri me 31 maj 2018, me kamatë ligjore prej 8% e cila fillon të rrjedh nga 1 qershori 2018 e tutje si dhe të ia kompensoj shpenzimet e shkaktuara procedurale në afatin prej 7 ditëve.

20. Parashtruesja e kërkesës përmes padisë, ndër të tjera theksoj *“veprime kundërligjore të ndërmarra nga ana e të Paditurës, për të degraduar pozitën time, në raport me përvojën time dhe kualifikimet e mia shkencore, konsideroj se me janë shkelur të gjitha të drejtat e mia të garantuara me Ligjin e Punës, sepse në kreun e III të këtij ligji ka është rregulluar “Sistemimi i të punësuarit në vendin e punës”, përkatësisht në nenin 17 pika 2 është thënë, citoi: “Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtte të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës”*
21. Më 31 dhjetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.184/2017] (i) refuzoj kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës si të pathemeltë; si dhe (ii) aprovoj tërheqjen e padisë së parashtrueses përmes së cilës kishte kërkuar që ta transferoj nga Zyra Regjionale në Gjakovë në Zyrën Qendrorë në Prishtinë.
22. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.184/2017] arsyetoj se vendimi [nr.01-2212/16] i 29 korrikut 2016 ishte nxjerr nga *“organi kompetent dhe si i tillë nuk ka qenë i orientuar vetëm mu këtu paditësen por për në tërë regjionin e Postës së Kosovës.”*
23. Më 28 janar 2018, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen aktgjykimi i lartpërmendura dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar, ose që aktgjykimi i kontestuar të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
24. Më 31 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.794/19] refuzoj si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoj Aktgjykimin [C.nr.184/2017] e Gjykatës Themelore me arsyetimin se *“aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë”*
25. Më 18 korrik 2022, parashtruesja e kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [Ac.nr.794/19] të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje të nenit 188 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet revizioni dhe çështja të kthehet në rivendosje në shkallë të parë.
26. Më 22 nëntor 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.387/2022] refuzoj revizionin e parashtrueses së kërkesës si të pathemeltë me arsyetimin se aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatimin e gabuar të drejtës materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesja e kërkesës pretendon që Aktgjykimi [Rev.nr.387/2022] i 22 nëntorit i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregull) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

28. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës në esencë pretendon se vendimi për ristrukturim [nr.01-2212/16] i 29 korrikut 2016 e rrjedhimisht rregullorja për kategorizimin e gradave për të punësuarit, si dhe me pas edhe kontrata e punës [nr.01-637/17] e 7 marsit 2017, kanë shkelur të drejtat e saj me arsyetimin se ishte degraduar në pozitë dhe pagë, përkatësisht nga grada 10 në gradën 7.
29. Në lidhje me shkeljet e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson se *"Gjykata Supreme ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës "E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm" në lidhje me neni 6.1 të KEDNJ-se "E Drejta për Proces të Rregullt", sepse gjatë vendosjes në këtë çështje nuk e ka zbatuar fare (nuk e ka përfillur) si dhe po ashtu nuk e ka arsyetuar fare në aktgjykimin e saj dispozitën e nenit 17 parag.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, të kërkuar dhe propozuar nga Parashtruesja (në Revizion), në të cilën dispozite decidivisht është precizuar, citoi: "Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë se tij dhe nivelit të njëjtte të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës" si dhe nenit 55 parag. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës dhe dispozitën e nenit 5 të Kontratë e punës që ishte në fuqi."*
30. Parashtruesja e kërkesës tutje thekson *"Gjykata Supreme në arsyetimin e saj thekson se Parashtruesja nuk e ka mbështetë me prova konkrete pretendimin e saj se e njëjta kontratën e punës e ka nënshkruar pa pëlqimin e saj si dhe thekson se këtu Parashtruesja ka patur mundësi që mos ta nënshkruaj kontratën kundër vullnetit të saj, mirë po e injoron argumentin dhe provën kryesore ku Parashtruesja ka potencuar disa herë faktin se me dt.28.02.2017, kundrejt vullnetit dhe dëshirës se saj ka nënshkruar Kontratën e punës, me komentin, në të cilin e ka shënuar, citoj: "E nënshkruaj pa pëlqimin tim për shkak të degradimit dhe mostransferit tim", e po ashtu edhe në Pëlqimin për nënshkrim kontrate dhe heqje dore nga çdo mjet juridik e ka shënuar, citoj: "Nuk Pajtohem" dhe ka refuzuar ta nënshkruaj. Ndërsa për ta vërtetuar këtë me dt.03.03.2017 nga Departamenti i Resurseve Njerëzore të Postës, është ftuar Paditësja përmes emailit zyrtar, duke i bërë presion i është thënë, citoi: "se duhet ta nënshkruaj Kontratën e punës pa komente"*
31. Në këtë aspekt, parashtruesja e kërkesës thekson se *"nuk është pajtuar asnjëherë me kontratën e re të punës, me te cilën ishte degraduar si në pozitë e po ashtu në pagë."*
32. Në vazhdim, parashtruesja e kërkesës pretendon se *"ishte e detyruar të nënshkruaj kontratën e punës (te dt.07.03.2017) kundër vullnetit të saj të lire duke gene e bindur se me një veprim te tille të refuzimit të nënshkrimit do te përballlej me pasoja serioze deri të humbja e vendit të punës (sepse dukej qarte tendenca e Postes për largimin e*

punëtoreve), mirëpo Parashtruesja menjëherë i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e saj që i'a garantojnë dispozitat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të saj”.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës

33. Në lidhjet me shkeljet e pretenduar të nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës pretendon se “Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj shkel Nenin 49 të Kushtetutës se nuk ka marre për bazë asnjërën nga argumentet dhe provat (që gjendeshin në shkresat e lëndës të dorëzuara nga Parashtruesja bashkangjitur Padisë), ndërsa ajo në arsyetimin e Aktgjykimit nuk e merr për bazë dhe nuk e ka arsyetuar fare as dokumentin e lëshuar nga vete organet-Shërbimi juridik pranë Postës së Kosovës, ku në atë dokument është dhënë Interpretimi-Opinion i Ligjor i Shërbimit Juridik ku ndër të tjera është thënë, citoi: " Ushtrimi i mjeteve juridikë si padite gjyqësore dhe ankesat pranë Inspektoratit të Punës do të jenë rrezik menaxherial për të cilin duhet të jemi koshient", ndërsa në emailin e dt.30.01.2017 të Drejtoreshës së Resurseve Njerëzore të Postës drejtuar Organeve Menaxheriale në Postë, po ashtu është thënë, citoi : "Interpretimi i Zyrës Ligjore për implementimin e fazës së dytë e dt.14.12.2016 është që mund të procedojmë, por me një risk se punëtorët mund ta fitojnë rastin pasi disa pozita janë shuar dhe punonjësit kanë kontrata të përhershme”

Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së

34. Në lidhje me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës pretendon se “Gjykata Supreme ka vendosur standarde të dyfishta sa i përket vendosjes dhe aplikimit të dispozitave materiale, për shkak se për raste të natyrës së njëjtte Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev.nr.186/2016 të dt.15.08.2016 dhe Aktgjyki. Rev.nr.119/2016 të dt.17.05.2016 si dhe Aktgjyki.Rev.nr-421/22 dt.31.10.2022 (gjëni bashk.) i ka refuzuar si të pabazuara Revizionet e ushtruar nga Posta e Kosovës kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, me të cilat janë vërtetuar aktgjykimet e Gjykatave Themelore, ndërsa në rastin e Parashtrueses ka përdor standard tjetër duke ia refuzuar Revizionin. Prandaj këtu është shkelur dispozita e nenit 24 paragrafi 1 i Kushtetutës [Barazia para Ligjit].”

Pretendimi në lidhje me shkeljen e nenit 54 dhe 55 të Kushtetutës

35. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsyetim në mënyrë të qartë dhe adekuate se si mund të jenë cenuar këto nene përmes Aktgjykimit të kontestuar.
36. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.387/2022] të 22 nëntorit 2022; dhe (ii) të kthejë rastin në rivendosje.

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

KONVENTA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 1 i Protokollit nr. 12

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 17

Caktimi i të punësuarit në vendin e punës

1. I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune.

2. Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës.

3. I punësuari sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

37. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

39. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashikohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve

47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. "Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]"

40. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2022] të 22 nëntorit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
41. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemachev kundër Francës](#),

Kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii).

43. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
44. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregull) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.
45. Gjykata do i adresojë veç e veç secilin nga këto pretendime duke aplikuar praktiken gjyqësore të GjEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

46. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre (i) nuk kanë adresuar si duhet argumentet/provat e paraqitura gjatë shqyrtimit të rastit; (ii) gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale, përkatësisht Gjykata Suprem nuk ka arsyetuar dispozitën e nenit 17 të Ligjit të Punës; si dhe (ii) Gjykata Suprem përmes vendimit të saj ka shkelur praktiken e saj gjyqësore duke vendosur ndryshe në rastet e njëjta.
47. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se në esencë parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi për ristrukturim [nr.01-2212/16] i 29 korrikut 2016 dhe kontrata e punës [nr.01-637/17] e 7 marsit 2017, kanë shkelur të drejtat e saj me arsyetimin se ishte degraduar në pozitë dhe pagë, përkatësisht nga grada 10 në gradën 7.
48. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se *“nuk është pajtuar asnjëherë me kontratën e re të punës, me të cilën ishte degraduar si në pozitë e po ashtu në pagë.”*
49. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se *“ishte e detyruar të nënshkruaj kontratën e punës (te dt.07.03.2017) kundër vullnetit të saj të lire duke qenë e bindur se me një veprim të tillë të refuzimit të nënshkrimit do të përballej me pasoja serioze deri të humbja e vendit të punës (sepse dukej qarte tendenca e Postes për largimin e punëtoreve), mirëpo Parashtruesja menjëherë i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e saj që i'a garantojnë dispozitat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të saj”*
50. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata thekson se të njëjtat, janë trajtuar nga gjykatat e rregullta. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore përmes

Aktgjykimit [C. nr. 184/2017] të 31 dhjetorit 2018, duke trajtuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

[...]

*Sa i përket kërkesës tjetër të paditëses që të anulohet kontrata e punës or. 01-637/2017, e datës 07.03.2017, sipas mendimit të gjykatës një kërkesë e këtillë, e të njëjtës duhet refuzuar. **Këtë nga fakti se kjo kontrate është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në procedurë, e njëjta është nënshkruar nga dy kontraktuesit (punëdhënësi dhe punëmarrësi), sipas të cilës paditësja është përcaktuar që t'i kryeje detyrat e punës Zyrtare e shitjes, marketingut dhe KnK-së, sipas rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të PK SHA - nr. 01-2720116, e datës 20.09.2016, ndërsa ne nenin 5 të të njëjtës kontrate është përcaktuar: "Të punësuarit i caktohet paga baze, për punën te cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi të gradës 7", Pra, meqë kjo kontrate është nënshkruar me vullnetin e plotë të kontraktuesve, të njëjtën gjykata e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshme, me te cilën paditësja është pajtuar që për punën të cilën e kryen të kompensohet në lartësi të gradës 7.***

[...]

*Edhe neni 17 par. 1 i Ligjit të Punës (Ligji or. 03/L-212, i cili ka hyre në fuqi me datë 16.12.2010, në mënyrë decedive, ka parapare se: **"I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur kontrate punë"**, siç rezulton edhe me paditësen në rastin konkret dhe në këtë kontekst gjykatës i rezulton si e pa themelte kërkesëpadia e paditëses, për çka edhe u vendose si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. [...]*

Në anën tjetër, siç është theksuar edhe me sipër paditësja, e ka nënshkruar kontratën e punës nr. 01-637/2017, të datës 07/03/2017, në versionin origjinal, sipas të cilës të njëjtës i është caktuar detyra e punës: Zyrtare e shitjes, marketingut dhe KnK-së, në njësinë Posta e Kosovës - lokacioni Gjakovë.

51. Gjithashtu, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 794/19] të 19 majit 2022, në kontekst të pretendimeve specifike të parashtrueses së kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

[...]

Gjykata e shkalles se pare ne baze te gjendjes faktike të vërtetuar, drejte ka zbatuar edhe të drejtën materiale nga fakti se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore që paditëses ti njihet e drejta për kthim në vendin e punës Koordinator Regjional për Shpërndarje dhe Dorëzim me gradën 10, si dhe kompensimin e ndryshimin të pagës në shumën prej 3,495.88 Euro (e llogaritur për periudhën 01.03.2017 deri me datën 31.05.2018) me kamat ligjore, me normën prej 8% vjetor, e cila fillon të rrjedhe nga data 01.06.2018 e tutje, si dhe t'ia kompensoje shpenzimet e shkaktuara procedurale, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes se aktgjykimit. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të gjykatës se shkalles se dytë, në rastin konkret mungon baza juridike për pagesën e diferencës se pagës, për faktin se paditësja me nënshkrimin e kontratës me të paditurën, vete është pajtuar edhe me lartësinë e pagës.

52. Në fund, Gjykata rikujton gjithashtu edhe Aktgjykimin [Rev.nr.387/2022] e Gjykatës Supreme, të 22 nëntorit 2022, duke trajtuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

[...] Pala paditëse me të paditurën ka nënshkruar kontrate me date 07.03.2017, gati një vit pas marrjes së vendimit për ristrukturim (vendimi nr.01-2212/16, i datës 29.07.2016), ku me këtë kontrate kanë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes tyre, dhe ndër të tjera edhe lartësinë e pagës ku paditësja ka pranuar që për pozitën zyrtare e shitjes, marketingut dhe Knk-së të marre lartësinë e pagës sipas gradës 7. Paditësja pretendon se kontratën e ka nënshkruar pa pëlqimin e saj, mirëpo një pretendim i tillë nuk është mbështetur në prova konkrete. [...]

53. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës. Të njëjtat, kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës, dhe kishin sqaruar se (i) vendimi [nr.01-2212/16] i 29 korrikut 2016 për arsyeje organizative kishte efekt kolektiv dhe jo individual vetëm ndaj parashtrueses së kërkesës; (ii) parashtruesja e kërkesës kishte dështuar të aplikonte në konkursin e brendshëm për “Koordinator Regjional”; si dhe (iii) kontrata e punës të 7 marsit 2017 ishte nënshkruar nga palët me vullnet të lirë dhe se parashtruesja e kërkesës para gjykatave të rregullta nuk kishte arritur të dëshmonte të kundërtën.
54. Gjykata verën se gjykatat e rregullta në rastin e parashtrueses së kërkesës kishin analizuar gjerësisht provat e paraqitura dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesja, dhe në fund kishin refuzuar ankesën e saj duke u bazuar në dispozitat përkatëse të LPK-së dhe Ligji nr. 03/l-212 i punës, që ato i kishin konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesja e kërkesës.
55. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja e kërkesës ngrit pretendime lidhur me aplikueshmerinë e paragrafit 2 të nenit 17 [Caktimi i të punësuarit në vendin e punës] të Ligji nr. 03/l-212 i Punës në rastin e saj nga Punëdhënësi.
56. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme “nuk e ka arsyetuar fare në aktgjykimin e saj dispozitën e nenit 17 parag.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, të kërkuar dhe propozuar nga Parashtruesja (në Revizion), në të cilën dispozite decidivisht është precizuar, citoi: “Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtte të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës” si dhe nenit 55 parag. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës dhe dispozitën e nenit 5 të Kontratë e punës që ishte në fuqi.
57. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të vë në spikamë arsyetimin e Gjykatës Themelore e cila përmes Aktgjykimit [C. nr. 184/2017] të 31 dhjetorit 2018, duke iu referuar nenit 17 të Ligji nr. 03/l-212 i punës kishte theksuar se “Edhe neni 17 par. 1 i Ligjit të Punës (Ligji or. 03/L-212, i cili ka hyre në fuqi me datë 16.12.2010, në mënyrë decidive, ka parapare se: “I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur kontrate punë”, siç rezulton edhe me paditësen në rastin konkret...”. Në anën tjetër, siç është theksuar edhe me sipër paditësja, e ka nënshkruar kontratën e punës nr. 01-637/2017, te datës 07/03/2017, në versionin origjinal, sipas të cilës të njëjtës i është caktuar detyra e punës: Zyrtare e shitjes, marketingut dhe KnK-së, në njësinë Posta e Kosovës - lokacioni Gjakovë.”

58. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit, e cila kishte theksuar se parashtruesja e kërkesës *“ka qenë në dënjë me kushtet e kontratës dhe në mënyrë të ligjshme duke shprehur vullnetin e saj, ka lidhur kontrate me të paditurën, duke i pranuar kushtet dhe detyrat që dalin nga kontrata, si dhe njeherit është pajtuar edhe për lartësinë e pagës të cilën siç u cek me lartë e përcakton specifikisht neni 5 i kontratës se punës të cekur me lartë.”*
59. Gjithashtu, lidhur me këtë çështje, edhe Gjykata Supreme kishte theksuar se *“[...] Pala paditëse me të paditurën ka nënshkruar kontrate me datë 07.03.2017, gati një vit pas marrjes së vendimit për ristrukturim (vendimi nr.01-221216, i datës 29.07.2016), ku me këtë kontrate kane përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes tyre, dhe ndër të tjera edhe lartësinë e pagës ku paditësja ka pranuar që për pozitën zyrtare e shitjes, marketingut dhe Knk-se të marre lartësinë e pagës sipas gradës 7”*
60. Gjykata vëren se paragrafi 2 i nenit 17 të Ligji nr. 03/1-212 i Punës përcakton se *“Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuarit në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës”*
61. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se tashmë parashtruesja veç kishte hyre në marrëdhënie të re kontraktuale me punëdhënësin përmes kontratës së punës së 7 marsit 2017, e cila sipas vlerësimeve të gjykatave të rregullta nuk ishte provuar se ishte lidhur kundër vullnetit të palëve.
62. Gjykata vëren se në bazë të pretendimeve të sipër cekura, parashtruesja kërkon rikthimin në pozitën e saj të mëparshme duke kërkuar anulimin e kontratës së punës së 7 marsit 2017, të cilën sipas vlerësimeve të gjykatave të rregullta, palët e kishin nënshkruar në bazë të vullnetit të tyre të lirë.
63. Përveç kësaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë bazuar vendimet e veta duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit të Punës, i cili thotë:

Neni 17

Caktimi i të punësuarit në vendin e punës

1. *I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Punë.*

[...]

64. Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta ofruan arsyeime përkatëse lidhur me refuzimin e ankesës së parashtrueses së kërkesës, duke konstatuar se kontratën e punës së 7 marsit 2017, palët e kishin nënshkruar në bazë të vullnetit të tyre të lirë. Po ashtu, gjykatat e rregullta kishin konstatuar se parashtruesja e kërkesës nuk kishte arritur të dëshmonte përgjatë gjitha procedurave gjyqësore se kontrata e nënshkruar ishte jo valide në kuptim të cenimit të vullnetit të lire të palëve dhe as që është paraqitur ndonjë fakt apo prove e mjaftueshme nga ana e parashtrueses që rrëzon konkluzionet e gjykatave të rregullta.
65. Gjykata vëren se në kërkesën e dorëzuar ndër të tjera theksohet se parashtruesja e kërkesës *“ishte e detyruar të nënshkruaj kontratën e punës (te dt.07.03.2017) kundër vullnetit të saj të lire duke qenë e bindur se me një veprim të tillë të refuzimit të nënshkrimit do të përballej me pasojat serioze deri të humbja e vendit të punës.”*

66. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se nuk mund të trajtoje rrethanat jashtëgjyqësore në të cilat ishte e përfshirë paraprakisht parashtruesja e kërkesës. Megjithatë, Gjykata vëren se pëlqimi i dhënë i parashtrues se kërkesës për krijimin e marrëdhënie se re kontraktuale të 7 marsit 2017 në rrethanat e sipër cekura ka prodhuar efekte juridike edhe në kuadër të procedurës gjyqësore të zhvilluar në rastin konkret.
67. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë shqyrtuar rrethanat ligjore të rastit, duke përfshirë pasojat juridike të dhënies se pëlqimit për krijimin e marrëdhënies se re kontraktuale dhe kanë vërtetuar faktet relevante mbi validitetin e kontratës.
68. Gjykata thekson se nenin 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; aktgjykimin [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
69. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se nenin 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02, vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
70. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme duke shtjelluar në detaje bazën ligjore kishte bazuar vendimin e saj, duke iu referuar dispozitave përkatës të Ligjit të punës që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret.
71. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
72. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqet pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare në mënyrë efektive; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rasti [KI128/18](#), i cituar më lart, paragrafi 58).
73. Në dritën e trajtimeve të mësipërme, Gjykata ve theksin në qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejte i ligjit është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e

ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, mutatis mutandis, rastin e Gjykatës Kushtetuese [KI86/21](#), parashtrues *Mirsad Bilbani*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2022; si dhe rastin [KI86/11](#), parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).

74. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së: [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI128/18](#), të cituar më lart, paragrafi 56; dhe [KI62/19](#), të cituar më lart, paragrafi 58).
75. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, janë pretendime që i takojnë kategorisë së (i) "shkallës së katërt" dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës

76. Parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta të cilat rezultojnë në refuzimin e ankesës së saj përbejnë shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimi të Profesionit] të Kushtetutës.
77. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës specifikisht pretendon se "Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj shkel Nenin 49 të Kushtetutës se nuk ka marrë për bazë asnjëherë nga argumentet dhe provat (që gjendeshin në shkresat e lëndës të dorëzuara nga Parashtruesja bashkangjitur Padisë), ndërsa ajo në arsyetimin e Aktgjykimit nuk e merr për bazë dhe nuk e ka arsyetuar fare as dokumentin e lëshuar nga vete organet-Shërbimi juridik pranë Postës së Kosovës, ku në atë dokument është dhënë Interpretimi-Opinionimi Ligjor i Shërbimit Juridik ku ndër të tjera është thënë, citoi: " Ushtrimi i mjeteve juridikë si padite gjyqësore dhe ankesat pranë Inspektoratit të Punës do të jenë rrezik menaxherial për të cilin duhet të jemi koshient", ndërsa në emailin e dt.30.01.2017 të Drejtoreshës së Resurseve Njerëzore të Postës drejtuar Organeve Menaxheriale në Postë, po ashtu është thënë, citoi: "Interpretimi i Zyrës Ligjore për implementimin e fazës së dytë e dt.14.12.2016 është që mund të procedojmë, por me një risk se punëtorët mund ta fitojnë rastin pasi disa pozita janë shuar dhe punonjësit kanë kontrata të përhershme"
78. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e ka artikuluar pretendimin e saj kushtetuese mbi arsyetimin për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimi të Profesionit] të Kushtetutës i cili thotë:

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimi të Profesionit]

1. *E drejta e punës garantohet.*
2. *Secili person është i lire të zgjedhe profesionin dhe vendin e punës.*

79. Gjykata thekson se e drejta e punës dhe ushtrimi të profesionit nga neni 49 i Kushtetutës është objekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës, ku këto të

drejta, me tej realizohen në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj, dhe kjo nënkupton edhe të drejtën e një individi që marrëdhënia e tij e punës të mos ndërpritet në kundërshtim me atë që është përcaktuar me ligj (Shih rastin e Gjykatës, [KI12/21](#), parashtruese e kërkesës Violeta Hamidi, Aktvendimi për papranueshmëri i 20 majit 2021)

80. Prandaj, dhe bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se e drejta e punës është e garantuar, për sa kohë që individi vepron në përputhje me ligjet në fuqi që e rregullojnë këtë fushë. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës veç kishte hyre në marrëdhënie të re kontraktuale me punëdhënësin përmes kontratës së punës së 7 marsit 2017, e cila sipas vlerësimeve të gjykatave të rregullta nuk ishte provuar se ishte lidhur kundër vullnetit të palëve.
81. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të saj të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, Gjykata i konsideron këto pretendime të pabazuara, sepse parashtrueses së kërkesës nuk iu mohua e drejta e punës.
82. Gjykata thekson se është obligim i parashtrueses së kërkesës që të dëshmojë pretendimet e saja kushtetuese dhe të paraqesë dëshmi *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastet e Gjykatës [KI19/14](#) i [KI21/14](#), parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri* dhe *Mehdi Sylja*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 shtatorit 2014).
83. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se gjykatat administrative, në tri shkallë në pajtim me ligjin, kanë shqyrtuar pretendimet ankimore të parashtrueses, me ç'raste edhe e kanë vërtetuar gjendjen faktike me rëndësi për nxjerrjen e vendimeve, duke përfshirë edhe Vendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2022], të cilin e konteston parashtruesja e kërkesës.
84. Prandaj, Gjykata është e mendimit se pretendimet e parashtrueses së kërkesës me Aktgjykimin e kontestuar asaj i është shkelur e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës, paraqet shprehjen e vlerësimit të saj subjektiv për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, por jo edhe dëshmi të vërtetë të shkeljes së të drejtave nga neni 49 i Kushtetutës.
85. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara sepse këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (ii) pretendimet që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*", ngase parashtrueses së kërkesës nuk i është ndërprere marrëdhënia e punës. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së

86. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës dhe nenin 1 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit] të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, në lidhje me trajtimin e pabarabartë.
87. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 të Kushtetutës me arsyetimin se "*Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev.nr.186/2016 të*

dt.15.08.2016 dhe Aktgjyqi. Rev.nr.119/2016 të dt.17.05.2016 si dhe Aktgjyqi.Rev.nr-421/22 dt.31.10.2022 (gjeni bashk.) i ka refuzuar si të pabazuara Revizionet e ushtruar nga Posta e Kosovës kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, me të cilat janë vërtetuar aktgjykimet e Gjykatave Themelore, ndërsa në rastin e Parashtrueses ka përdor standard tjetër duke ia refuzuar Revizionin.”

88. Në lidhje me këto pretendime të parashtrueses së kërkesës, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thotë se “*diskriminimi përben trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme.* (shih rastet e GJEDNJ-së [Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 36042/97](#), paragrafi 48; [Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë, kërkesa nr. 15250/02](#), paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 44).
89. Më tej, Gjykata rikujton që në mënyrë që pretendimet e parashtrueses në lidhje me shkeljen e të drejtës për mosdiskriminim të jenë të suksesshme, ajo, inter alia, duhet të dëshmojë se pozita e saj mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (shih: [Fredin kundër Suedisë \(nr. 1\), kërkesa nr. 12033/86](#), paragrafi 60, GJEDNJ, Aktgjykim i 18 shkurtit 1991, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), cituar më lart, paragrafi 45).
90. Sa i përket rastit konkret, Gjykata gjen se parashtruesja e kërkesës i vë në dukje pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së në lidhje me trajtimin e pabarabartë. Duke i ndërlidhur pretendimet me rastin konkret, si dhe me garancitë dhe parimet e nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesja e kërkesës të gjitha pretendimet e lidhura me pohimet e saj, i sjellë në kontekstin e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të së drejtës materiale.
91. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e mbështetë pretendimin e saj për trajtim të pabarabartë me arsyetimin se Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe përkitazi me aplikimin e dispozitave materiale në rastet e natyrës se njëjtë, duke vepruar në kundërshtim me praktiken e saj gjyqësore.
92. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës e mbështet pretendimet e saj me arsyetimin se në rastin e saj, Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe përkitazi me aplikimin e dispozitave materiale në rastet e natyrës se njëjtë, duke vepruar në kundërshtim me praktiken e saj gjyqësore. Në mbështetje të argumenteve të saj, ajo iu referohet (3) Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, si në vijim: (i) Aktgjykimi [Rev. nr. 119/2016] të 17 majit 2016; (ii) Aktgjykimi [Rev.nr.186/2016] të 15 gushtit 2016; dhe (iii) Aktgjykimit [Rev.nr.421/22] të 31 tetorit 2022.
93. Në rastin e parë, Aktgjykimi [Rev.nr.119/2016] i 17 majit 2016, të Gjykatës Supreme, rrethanat e rastit ndërlidhen me një kontratë në kohë të pacaktuar të lidhur mes të punësuarit dhe punëdhënësit, në gradën 8. Punëdhënësi përmes një aktvendimi përcaktoi të ardhurat personale ndaj të punësuarit në nivel të gradës 7 prej 1 shkurtit 2021 e tutje, duke e konsideruar këtë aktvendimi si pjesë përbërës të kontratës së punës. Gjykata Themelore anuloi vendimin për uljen e pagës së të punësuarit prej gradës 8 në 7 dhe detyroi punëdhënësin që të punësuarit t'i paguaje diferencën e pagës sipas gradës 8, me arsyetimin se punëdhënësi duke ia ulur të punësuarit gradën nga 8 në 7 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të punës dhe kontratën e punës. Ky aktgjykim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme me arsyetimin se i punësuarit “*ka të drejtën e pagës e cila i caktohet te punësuarit me kontrate te punës ne*

pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit, sipas kontratës së punës, ka qene sipas gradës 7, prandaj ulja e saj nën këtë grade është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit të Punës.”

94. Në rastin e dytë, Aktgjykimi [Rev.nr.186/2016] i 15 gushtit 2016, të Gjykatës Supreme, rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontratë në kohë të caktuar të lidhur mes të punësuarit dhe punëdhënësit, në gradën 12. Punëdhënësi përmes një aktvendimi përcaktoi të ardhurat personale në lartësi të gradës 9. Gjykata Themelore anuloi vendimin për uljen e pagës së të punësuarit prej gradës 12 në 9 dhe detyroi të paditurën që paditësit t’ia paguaje diferencën e pagës sipas gradës 12, me arsyetimin se punëdhënësi duke ia ulur të punësuarit gradën nga 12 në 9 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të punës dhe kontratën e punës. Ky aktgjykim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme me arsyetimin se i *“punësuarit ka të drejtën e pagës e cila i caktohet me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e punës, kontratën kolektive, dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit.”*
95. Në rastin e tretë, Aktgjykimi [Rev.nr.421/22] i 31 tetorit 2022, rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontratë të lidhur mes të punësuarit dhe punëdhënësit me pagën baze të gradës 8. Punëdhënësi përmes një vendimi i caktoi të punësuarit të ardhurat personale mujore me lartësi të gradës 7. Pas ankesës nga i punësuarit, Gjykata Themelore detyroi punëdhënësin që të paguaj kompensimin e diferencës së pagës ndaj të punësuarit. Ky aktgjykim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme me arsyetimin se *“sepse sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 8 dhe ulja nën këtë grade është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit.”*
96. Lidhur me të lartcekurat, Gjykata fillimisht verën se nga vendimet e bashkëngjitura nga ana e parashtrueses së kërkesës, rezultojnë të jenë raste të ndryshme nga rasti konkret sepse në vendimet e lartcekura, palët kishin një kontratë të lidhur ku nivel i pagës parashihej sipas një grade të caktuar dhe punëdhënësi përmes një vendimi tjetër kishte ndryshuar gradën e përcaktuar në kundërshtim me kontratën e punës.
97. Gjykata vëren se në rastin konkret të parashtrueses së kërkesës, grada 7 është përcaktuar në pajtim me kontratën respektivisht marrëdhënien kontraktuale të krijuar mes saj dhe punëdhënësit me 7 mars 2017.
98. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, përpos një përshkrimi të thjeshtë të këtyre Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, nuk ka sqaruar se si kanë ngjashmëri faktike dhe juridike rastet përkatëse me rastin pranë nesh dhe si ka rezultuar kjo në vendime kundërthënëse dhe diskriminuese në disfavor të saj.
99. Gjykata thekson se, bazuar në praktiken gjyqësorë të GJEDNJ-së, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedurë dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktike gjyqësorë, parashtruesit e kërkesave duhet të i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në shkelje të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të pretenduara nga parashtruesit.
100. Gjykata konsideron se sqarimi i dhënë i Gjykatës Supreme përmes vendimit të saj në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit në rastin konkret është i qartë, përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra.

101. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses të kërkesës për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, janë (i) pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj Gjykata, si të tilla, në baza kushtetuese i deklaroi qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimi për shkelje të nenit 54 dhe 55 të Kushtetutës

102. Përveç pretendimeve tjera të lartcekura, parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje edhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
103. Parashtruesja e kërkesës përtej referimit në nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe përmbajtjen e tyre dhe përtej formulimit të pretendimeve të përgjithësuara, nuk ka arsyetuar në mënyrë të qartë dhe adekuate se si mund të jenë cenuar këto nene përmes Aktgjykimit të kontestuar.
104. Gjykata rikujton që ajo tashmë ka një praktikë shumë të konsoliduar përmes të cilës vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës [KI02/18](#), parashtrues Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor], Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe [KI95/19](#), parashtrues Ruzhdi Bejta, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 300 deri më 303).
105. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës, bien në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura apo paarsyetuara*”. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata, duke u bazuar në paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
106. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 dhe 55 të Kushtetutës, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

107. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses është e papranueshme, sepse pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës janë pretendime që i takojnë kategorisë së (i) “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; pretendimet për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës janë pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe si të tilla janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; ndërsa

pretendimet për shkelje të nenit 24, 54 dhe 55 janë pretendime që kategorizohen si (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara” në baza kushtetuese.

108. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa, në tërësinë e saj, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, 7 qershor 2023 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani